



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 4028 prot.

Himarë, më 18.07.2024

VENDIM

Nr. 07 datë 18.07.2024

PËR MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 17,56 dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB, Nr. 33 datë 28.07.2023 neni 27. Kryesia e këshillit në mbledhjen e datës 18.07.2024

VENDOSI:

- Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e Këshillit Bashkiak e cila do të mbahet më datë 24.07.2024.
- Ngarkohet sekretari këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
- Ngarkohet sekretari këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës si dhe materialet relevante të mbledhjes tek secili këshilltar, tek kryetari Bashkisë, deputetët e qarkut, tek personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltarë dhe tek kryetari Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Sekretar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr \_\_\_\_\_ . prot.

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**LËNDA: BASHKËLIDHUR VENDIMIT NR. \_\_ DATË 18.07.2024, MIRATUAR NGA KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK NË MBLEDHJEN E DATËS 18.07.2024 “ PËR MIRATIMIN PARAPARAK TË RENDIT TË DITËS DHE PËRCAKTIMLN E DATËS SË MBLEDHJES PËR KËSHILLIN BASHKIAK, MUAJI KORRIK 2024”.**

Kryesia e këshillit vendosi se mbledhja e muajit korrik do të mbahet më datë 24.07.2024, ora 10:30, me rend dite si më poshtë;

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e ndryshimeve buxhetore”.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e rregullores së menaxhimit të mbetjeve voluminoze në Bashkinë Himarë”.
4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 30 qershor, 2024, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike”.

Sekretari  
Elena Memushaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 4025/prot.  
1

Himarë, më 18.07.2024

**NJOFTIM**

**Lënda :** Njoftim për mbledhjen e komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak Himarë

**Drejtuar:** Anëtarëve të komisioneve të përhershme.

**Drejtoria e financës , planifikimit të buxhetit dhe integrimin evropian.  
Drejtoria e shërbimeve publike dhe mbështetëse.**

Ju njoftojmë se mbledhjet e komisioneve të përhershme për shqyrtimin e projektvendimeve do të zhvillohen në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë si më poshtë :

**1.Komisioni ekonomisë, financës dhe auditit datë: 24.07.2024 ,ora 8:30**

**Shqyrtimi i projektvendimit “Shqyrtimi i projektvendimit “ Për ndryshimet buxhetore qershor 2024.**

**Shqyrtimi projektvendimit “Për tavanet buxhetore përfundimtare 2025-2024”.**

**Anëtarë komisioni:**

- 1.Gjergj Iliadhi.
- 2.Miltiadh Prifti.
- 3.Silva Burbo.
- 4.Loreta Isufi.
5. Maks Vlasi.

2.Komisioni i zhvillimit urban , infrastrukturës dhe shërbimeve mbështetëse datë 24.06.2024 , ora 9:30

Shqyrtimi i projektvendimit " Për miratimin e rregullores së mbetjeve voluminoze në Bashkinë Himarë".

Anëtarë komisioni .

1. Timolço Gërdhuqi
2. Qirjako Mërkuri
3. Artonil Shirokaj
4. Afrovita Dhimojani
5. Aleks Llazari
6. Artan Bala
7. Gjergji Iliadhi

SEKRETARI

Elena Memushaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4028/prot.  
2

Himarë, më 18.07.2024

### NJOFTIM

**Lënda :** Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Himarë.

Të nderuar këshilltarë!

Ju njoftoj se ditën e mërkurë më datë 24.07.2024, ora 10:30 në sallën " Neço Muko" Himarë do të zhvillohet mbledhja e radhës për muajin korrik e Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, neni 53, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vëndore", i ndryshuar. Mbledhja do të ketë renditje të mëposhtme:

I. Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit " Për miratimin e ndryshimeve buxhetore qershor 2024".
2. Shqyrtimi i projektvendimit " Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027".
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit "Për miratimin e rregullores së menaxhimit të mbetjeve voluminoze në Bashkinë Himarë".
4. Informacion për marrjen e masave të përballimit me sukses të situatave të zjarreve dhe shpëtimit gjatë sezonit turistik.
5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për propozim për dhënie të ndihmës ekonomike për periudhën 1 – 30 qershor 2024, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok – ndihmës ekonomike".
6. Të ndryshme.

Sekretari  
Elena Memushi

